

## Konventa e Lisbonës - Ç'është kjo?

*Konventën për njohjen e kualifikimeve profesionale të arsimit të lartë në regjionin e Evropës e kanë përpiluar Këshilli Evropian dhe UNESCO-ja, dhe e kanë aprovuar përfaqësuesit nga shtetet përkatëse në Lisbonë, nga 8-11 prill 1997. Kjo Konventë e Këshillit Evropian /UNESCO-s – që rëndom emërtohet Konventa e Lisbonës – tanimë është miratuar në shumicën e vendeve të Evropës. Tekstin e plotë të Konventës dhe listën e nënshkrimeve e të miratimeve që vazhdimisht plotësohen mund ta gjeni në: <http://conventions.coe.int>; ku duhet të kërkoni: ETS 165.*

Ndër çështjet kryesore që i trajton Konventa e Këshillit Evropian /UNESCO-s mund të përmenden disa:

- Individët që kanë kualifikime profesionale nga njëri shtet do të kenë mundësi që këto t'u vlerësohen zyrtarisht në shtetin tjetër.
- Vlerësimi zyrtar i dëshmive të kualifikimit profesional nuk do të tolerojë asnjë diskriminim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, të metave dhe handicapimit, gjuhës, përkatësisë fetare, politike, kombëtare, etnike, apo shtresës shoqërore.
- Komisioni përkatës për vlerësimin e dëshmisë së kualifikimit profesional është përgjegjës për arsyetim nëse aplikimi nuk i përmbush kërkesat e duhura.
- Secili shtet do t'i pranojë dëshmitë e kualifikimit profesional – kur është në pyetje mundësia për t'u përfshirë në arsimin e lartë, apo kur bëhet fjalë për qëndrime studimore të periudhave të caktuara në programe të titujve profesionalë – sipas kualifikimeve korresponduese në sistemin e vet shkollor, përpos atëhere kur dëshmohet se ka dallime të qenësishme mes kualifikimeve profesionale të atij shteti dhe atyre që duhet të pranohen si të barazvlefshme.
- Pranimi i dëshmive të kualifikimit të lartë profesional nga njëri shtet në një tjetër do t'i krijojë këto mundësi:
  - a. vazhdimin e përsosjes së lartë profesionale, duke përfshirë këtu edhe provimet e rëndësishme dhe përgatitjen për doktoranturë, me kushtet e njëjta si për kandidatët e shtetit nga i cili kërkohet pranimi i diplomës përkatëse;
  - b. shfrytëzimin e titullit akademik, sipas ligjeve dhe rregullave të shtetit nga i cili kërkohet verifikimi.

Gjithashtu, ky verifikim mund ta lehtësojë përfshirjen në tregun e punës.

- Të gjitha shtetet do ta përcaktojnë procedurën sipas së cilës verifikohet se sa i plotësojnë kërkesat përkatëse për përfshirje në arsimin e lartë apo për punësim refugjatët apo personat e shpërngulur, madje dhe në rastet kur titujt e kualifikimit profesional nuk mund të dëshmohen me dokumentat përkatës.

- Të gjitha shtetet do të ofrojnë të dhëna për institucionet dhe programet që zyrtarisht përfshihen në sistemin e tyre të arsimit të lartë.
- Të gjitha shtetet do të themelojnë qendra kombëtare të informimit, një nga detyrat e rëndësishme të të cilave është të ofrojnë këshilla për njohjen zyrtare të diplomave të huaja për studentë, të diplomuar, për punëdhënës, institucione të arsimit të lartë, apo për palët e tjera të interesuara.
- Të gjitha shtetet do t'u rekomandojnë institucioneve të veta të arsimit të lartë që studentëve t'u japin Diplomë Plotësuese në mënyrë që të lehtësohet njohja zyrtare e kualifikimit profesional. Diploma Plotësuese është një dokument që e kanë përluar bashkarisht Komisioni Evropian, Këshilli Evropian dhe UNESCO-ja, dhe ka për qëllim ta përshkruajë kualifikimin profesional në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme duke e vendosur në kontekstin e sistemit arsimor përkatës.